



Pyetje për Testimin e Njohurive për Raportimin Financiar

A. Rrethoni përgjigjen e saktë

1. **Pse përgatiten pasqyrat financiare?**
 - a. Për të plotësuar kërkesat ligjore
 - b. Për të llogaritur tatimin
 - c. Për Kreditorët
 - d. Të gjitha më lart
2. **Kush i përgatit pasqyrat financiare?**
 - a. Drejtori i financës
 - b. Një i punësuar që ka kualifikimin e duhur
 - c. Një konsulent me licencë të posaçme
 - d. Të gjitha më lart
3. **Kush i autorizon pasqyrat financiare?**
 - a. Tatimet
 - b. Drejtori i Financës
 - c. Administratori
 - d. Drejtuesi i kontrollit të brendshëm
4. **Kush i aprovon pasqyrat financiare?**
 - a. Asambleja e Ortakëve
 - b. Banka e Shqiperise
 - c. Audituesi i pavarur
 - d. Autoriteti i mbikëqyrjes financiare
5. **Kush i përdor pasqyrat financiare?**
 - a. Publiku
 - b. Ortakët
 - c. Drejtuesit
 - d. Kreditorët
 - e. Bankat
 - f. Tatimet
 - g. Agjencitë qeveritare
 - h. Konkurrentët
 - i. Të gjitha me lart
6. **Sa vite duhet të ruhet informacioni financiar?**
 - a. Një vit
 - b. Dhjet vite
 - c. Përgjithmonë
 - d. Sa ta vendosë Banka



7. **Cilat janë institucionet që mund të konfirmojnë saktësinë e pasqyrave financiare?**
- Tatimet
 - Audituesit
 - Institucionet e ndryshme të licencave dhe akreditimeve
 - QKB
 - Të gjitha më lart.
8. **Si mund të mund të verifikohet nëse pasqyrat financiare në një dosje në gjykim janë të njëjta me ato që janë publikuar?**
- Duke kërkuar ekzaminim nga eksperte të fushës
 - Duke marrë deklarate Drejtuesve të shoqërisë
 - Duke parë nëse janë të firmosura nga Administratori
 - Duke verifikuar pagesën e taksave
9. **Cilët zëra të pasqyrës së bilancit preken kur shoqëria paguan një detyrim nga llogaria bankare?**
- Zvogëlohet teprica në bankë, zvogëlohen detyrimet për tu paguar
 - Pakësohet fitimi dhe ulen detyrimet
 - Pakësohet banka dhe rriten shpenzimet
 - Pakësohet kapitali dhe rriten aktivet
10. **Si pasqyrohet marrja e një huaje nga Banka në Pasqyrat Financiare të shoqërisë.**
- Rriten interesat e paguara dhe zvogëlohet fondet në bankë
 - Rriten mjetet monetare në bankë, rriten dhe detyrimet e huamarrjes
 - Rritet kapitali i shoqërisë, rriten dhe fitimet e ortakeve
 - Pakësohen aktivet afatgjate dhe rriten detyrimet për huamarrje
11. **Çfarë zëra të shpenzimeve preken kur llogarisim dhe kontabilizojmë pagat e personelit për muajin përkatës.**
- Shpenzimet direkte të prodhimit
 - Shpenzime të vitit të kaluar
 - Shpenzime për tatimin në burim
 - Shpenzimet për paga dhe kontribute shoqërore
12. **Si reflektohet në pasqyrën e bilancit, pagimi i kapitalit fillestar në para?**
- Rriten mjete transporti, dhe ulen shpenzimet e amortizimit
 - Zvogëlohen llogaritë e arkëtueshme, dhe rriten shpenzimet për borxhin e keq
 - Rriten mjetet monetare në banke, dhe shtohen kapitalet e veta
 - Rritet llogaria dividend për tu paguar dhe pakësohen mjetet monetare në bankë
13. **Cilat zëra të pasqyrave financiare preken kur bëjmë një shitje me arkëtim me para në dorë?**
- Shtohen paratë në arkë dhe shtohen të ardhurat?
 - Pakësohen mallrat për shitje dhe rriten inventari në proces?
 - Shtohet gjendja në arke dhe zvogëlohet gjendja në Bankë?
 - Rriten Mallrat në transit, dhe shtohen shpenzimet për blerje?



- 14. Çfarë zëra të pasqyrave financiare preken kur bëjmë një shitje me arkëtim të mëvonshëm?**
- Rritet borxhi i keq dhe shtohen shpenzimet për blerje malli
 - Ritet llogaria e kërkesave për arkëtim dhe rriten detyrimet për lëvrim malli
 - Ritet llogaria e kërkesave për arkëtim dhe rriten të ardhurat
 - Pakësohet banka dhe ulen të ardhurat në buxhet
- 15. Në cilin zë të pasqyrave financiare e gjejmë shpenzimet për interesa huaje?**
- Në zërin e të ardhurave nga interesi
 - Ne zërin Llogarisë bankare
 - Në zërin e pagave
 - Në zërin e shpenzimeve financiare
- 16. Në cilin zë të pasqyrave financiare e gjejmë një borxh që shoqëria ka ndaj Ortakut të saj?**
- Detyrime të tjera ndaj palëve të lidhura
 - Detyrime ndaj Bankës
 - Detyrime ndaj Furnitorëve
 - Të drejta për arkëtim nga Klientët?
- 17. Shoqëria lëshon një faturë shitje për mallra me vlerë 100,000 plus 20,000 Lek TVSH. Kush është shuma e të ardhurave të shoqërisë?**
- 120,00 Lek
 - 240,000 Lek
 - 100,000 Lek
 - 60,000 Lek
- 18. Cila evidencë e jashtme na ndihmon të verifikojmë që shuma e mjeteve monetare të raportuara në fund të vitit është pasqyruar e saktë?**
- Deklarata e përgjegjësimit të kontabilitetit
 - Raporti i auditimit
 - Nxjerrje e llogarisë bankare
 - Konfirmimi nga Pronaret
- 19. Kur paguhen detyrimet tatimore?**
- Sa më parë të jete e mundur
 - Në muajin pasardhës ose kur e përcakton ligji
 - Kur të merr ne telefon administrata tatimore
 - Kur te aprovojë banka huanë bankare
- 20. Ku pasqyrohen detyrimet e pa paguara tatimore?**
- Në detyrimet afatshkurtra ne bilanc
 - Në *e-mail*-in qe Financa i dërgon Administratorit,
 - Ne Buxhetin e vitit aktual
 - Konfirmimin që marrim nga Audituesi



- 21. Si mund të verifikojmë nëse detyrimet tatimore janë shlyer apo jo?**
- Duke shqyrtuar pagesat nga llogaria bankare e shoqërisë
 - Duke parë sistemin tatimor *online*
 - Duke kërkuar konfirmim nga tatimet
 - Çdonjëra prej tyre.
- 22. Si mund të verifikojmë që një borxh i pretenduar nga një palë e tretë është reflektuar si duhet në pasqyrat financiare të shoqërisë debitorë (me borxhe).**
- Duke kërkuar zbërthimin analitik të zërit përkatës të detyrimeve në bilanc
 - Duke parë shënimet shpjeguese për politikën kontabël
 - Duke parë pasqyrat financiare të viteve të kaluara
 - Duke parë planin e pagesave për muajt e ardhshëm të Administratorit.
- 23. Çfarë është pasqyra e Pozicionit Financiar?**
- Një tabelë me llogarite bankare të shoqërisë
 - Një fotografi e pasurive dhe detyrimeve të shoqërisë në një datë të caktuar
 - Një pasqyrë që tregon se shoqëria paguan taksa
 - Një informacion që përgatitet për Bankën
- 24. Çfarë informacioni mund të marrim prej pasqyrës së pozicionit financiar?**
- Sa punonjës ka shoqëria
 - Kush janë ortakët
 - Sa janë detyrimet e shoqërisë në një datë të caktuar
 - Sa vite do vazhdojë aktiviteti i shoqërisë
- 25. Ku pasqyrohen detyrimet për një Hua bankare afatgjatë?**
- Në pasqyrën e Fluksit të mjeteve monetare
 - Në deklaratën individuale të të ardhurave
 - Në Detyrimet afatgjatë në Pasiv të Pasqyrës së Bilancit
 - Asnjëra nga këto
- 26. Ku pasqyrohen llogaritë e arkëtueshme nga Klientët?**
- Në aktivet qarkulluese të Pasqyrës së Bilancit
 - Në Deklaratën e TVSH
 - Në Raportin Mujor të Drejtorit të Financës
 - Në Kontratën e klientit
- 27. Me çfarë burimesh financohen blerja e aktiveve, materialeve dhe aktiveve të tjera?**
- Me kapitalin e Ortakëve
 - Me fitimet e pa shpërndara nga shoqërisë
 - Me hua Bankare
 - Të gjitha më lart
- 28. Në cilin element të Pasqyrave financiare pasqyrohen pasuritë e paluajtshme?**
- Aktive qarkulluese
 - Aktive materiale afatgjatë
 - Fitime të pashpërndara
 - Tatime për tu paguar



29. Në cilin element të Pasqyrave financiare pasqyrohen tatime të rimbursueshme (TVSH për tu rimbursuar)?

- Në faqen e parë ku jepen informacionet e përgjithshme
- Në detyrime tatimore për tu paguar
- Në aktive afatshkurtër të pasqyrës së bilancit, Tatime për tu arkëtuar
- Në tabelën e Amortizimit të aktiveve afatgjatë

30. Si i paraqesim tepricat e llogarive të bilancit në monedhë të huaj?

- Nuk i paraqesim fare
- Të konvertuara në Monedhën LEK
- I paraqesim vetëm në Euro
- I paraqesim vetëm me shënime shpjeguese

31. Kush nga zërat më poshtë nuk është pjesë e Kapitaleve të veta?

- Kapitali themeltar
- Rezerva rivlerësimi
- Hua për tu paguar pas 10 vitesh
- Fitime të pa shpërndara

B. Pyetje me përgjigje të shkurtra

- Pse janë të rëndësishme shënimet shpjeguese? Çfarë gjejmë aty?
- A ndryshojnë pasqyrat financiare pasi janë përgatitur dhe publikuar?
- Si mund të përdoren pasqyrat financiare për të nxjerrë prova të besueshme për drejtësinë?
- Si e kuptojmë frazën “arkëtim nga klienti”. Çfarë zërash të pasqyrave prek ky veprim?
- Çfarë veprimi do bëhej në rast se shoqëria i paguan ortakut dividend. Cilat zëra të pasqyrave preken në këtë rast?
- Si mund të kërkojmë evidencë shtesë për një pretendim se një faturë është pranuar dhe nuk është paguar nga klienti (debitor)? Cila është evidenca më e besueshme?
- Ku mund të gjejmë evidencë që shoqëria ka paguar garancinë për një qira ambienti? Në cilin zë të pasqyrave financiare paraqitet kjo shumë?
- Nëse shoqëria pretendon se ka humbje të mëdha nga luhatjet e kursit të këmbimit të monedhave të huaja, ku reflektohen këto humbje, dhe me çfarë prova kontabël dokumentohen?
- Shoqëria ka pranuar që një klienti i sajë të shlyejë borxhin duke e këmbyer me një pasuri të paluajtshme. A është e lejuar? Ku pasqyrohet? Cilat janë dokumentet e duhura?
- Çfarë forme kanë marrëdhëniet me palët e lidhura?
- Çfarë quajmë borxh i keq?
- Çfarë natyre kanë marrëdhëniet me Ortakët dhe palët e lidhura? Si janë krijuar ato?



44. Ku paraqiten Huatë e falura nga Ortakët para se ato të falen?
45. Pse ndahen Aktivitet dhe detyrimet në Afatshkurtër dhe Afatgjatë?
46. Kush i aprovon fshirjen e debitorëve të këqinj?
47. Si merret një hua dhe kush e ka përgjegjësinë për një hua të papaguar?
48. Si realizohet shitja e Aktiveve afatgjatë – Pasuri e paluajtshme?
49. Çfarë është pasqyra e Performancës dhe çfarë informacioni mund të marrim prej saj?
50. Cili është dallimi midis të ardhurave nga aktivitetit kryesor dhe të ardhurave të tjera?
51. Kur themi që të ardhurat janë realizuar?
52. Në cilin zë të pasqyrës së performancës do gjejmë të ardhurat nga shitja e mallrave?
53. Në cilin zë të pasqyrës së performancës do gjejmë të ardhurat nga interesat?
54. Çfarë janë shpenzimet direkte?
55. Çfarë janë shpenzimet e përgjithshme?
56. Në cilën pasqyrë financiare paraqiten shpenzimet për qira zyre?
57. Në cilën pasqyrë financiare paraqiten shpenzimet për Amortizim?
58. A janë humbjet nga monedhat e huaja pjese e kostos së mallrave dhe shërbimeve?
59. Ku mund të marrim informacion për pagat e punonjësve?
60. Ku mund të marrim informacion për shpenzimet e paguara për qira?
61. Ku mund ta shikojmë të pasqyruar nëse shoqëria ka paguar interesa për një hua bankare?
62. Ku mund ta shikojmë të pasqyruar nëse shoqëria ka paguar për siguracion ndërtese?
63. A mund të quajë shoqëria shpenzime të aktivitetit, blerjen e një Jahti për familjen e Ortakut të vetëm?
64. A lejohet Shoqërisë të ketë gjendje inventari më shumë sesa shitjet mesatare mujore?
65. A mund të quajë shoqëria shpenzime tarifën e shkollës që paguan Ortakut nga fondet shoqërisë për djalin e tij në një universitet në Angli?
66. A mund ti japë shoqëria Administratorit një bonus me të madh se 10 paga mujore për arritje rezultate të mira të shoqërisë.